



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 5464 prot.

Ballsh, më 31.10.2024

VENDIM

Nr. 53, datë 29.10.2024

**“PËR
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 61, DATË 21.12.2023 “PËR
MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË BASHKISË
MALLAKASTËR, INSTITUCIONEVE NË VARËSI, FUNKSIONEVE TË
TRANSFERUARA DHE DELEGUARA PËR VITIN 2024”**

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, të ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo –territoriale të njësive të qeverisjes vendore”, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, ndryshuar, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, ndryshuar, të ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të ligjit nr. 35/2023 “ për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, të VKM-së nr. 328, datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, ndryshuar me VKM-në nr. 503, datë 01.08.2024, si dhe shkresës Nr.4938 datë 03.10.2024 të Agjencisë për mbështetjen e vetqeverisjes vendore,

VENDOSI

1. Në pikën I të Vendimit nr. 61, datë 21.12.2023 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve, të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar të Bashkisë Mallakastër, institucioneve në varësi, funksioneve të transferuara dhe deleguara për vitin 2023 sipas lidhjes nr. 1,2,3,4,5,6,7,8,9”, bëhen këto ndryshime:

- Ndryshimin e nivelit të pagave për nëpunësit civil-e punonjës administrativ që kryejnë veprimtari administrative, sekretarie, mirëmbajtje në Bashkinë Mallakastër dhe institucioneve në varësi, pjesë përbërëse e këtij tvendimi.
- Pika 1 dhe 9 e lidhjes nr. 2 të vendimit nr. 61 datë 21.12.2023 si dhe në pikën 7 të lidhjes nr. 8 të vendimit nr.61 datë 21.12.2023 të Këshillit të Bashkisë, ndryshohen sipas tabelës bashkëlidhur.
- Pika 1 e lidhjes Nr.2 e vendimit nr.45 datë 25.09.2024 shfuqizohet.
- Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pika 6 e ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

KRYETAR

Nexhmi Sulaj



Niveli i pagave (Nëpunës Civil dhe administrativ)

Tabela nr.1

Nr.	Emërtimi	Kategoria	Arsimi	Paga e grupit	Shtesë Vjetërsie	Shtesë pozicioni
1.	Sekretar i Përgjithshëm	I-5	I lartë	1	10 vjeçari pare 0,6% /vit 10 vjeçari dytë 0,8% /vit 10 vjeçari tretë 1% /vit	160.000
2	Punonjës administrativ me arsim të mesëm në administratë dhe institucionet e varësisë, që kryejnë veprimtari administrative, sekretarie mirëmbajtje, ruajtjeje. (Sekretar, arkivist, magazinier, punonjës informacioni, arkëtar, fotograf)	VKM nr.328 datë 31.05.2023	I mesëm		1 %	47000
3.	Përgjegjës sektori në institucionin e varësisë me arsim të mesëm	Vkm nr.328 datë 31.05.2023	I mesëm		1%	65000

KRYETAR

Nexhmi Sulaj

